



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:058441
Datë: 11.01.2024
Numri i dokumentit: 05180094

Ka. nr. 449/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e Kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj, anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurës Subjektit Ekonomik “Al Petroll” SHPK, si person juridik, Njësia në fshatin Vragoli – Komuna e Fushë Kosovës, me Drejtor - Hasime Kryeziu, me NRB 81032162, për kundërvajtje nga neni 15 par. 3 sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.3 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme dhe UA – QRK Nr. 03/2022 për rregullimin e çmimeve të Produkteve të naftës dhe karburante të Ripërtrishme dhe Masave të tjera Mbrojtëse, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga e pandehura “Al Petroll” SHPK, përmes Përfaqësuesit të autorizuar Elmaze Jashari, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 1316/2022, të datës 23.11.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe nenit 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe par. 2, të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, më datë 09.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga e pandehura Subjektit Ekonomik “Al Petroll” SHPK, si person juridik, Njësia në fshatin Vragoli – Komuna e Fushë Kosovës, me Drejtor - Hasime Kryeziu, me NRB 81032162, ndërsa **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 1316/2022, i datës 23.11.2023, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e Ministrisë së dhe Industrisë, Nërmarrësisë dhe Tregtisë - Inspektorati i Tregut, me Nr. Ref 19/1680-19, të

datës 21.03.2022, me aktgjykim K. nr. 1316/2022, të datës 23.11.2023, të pandehurën “Al Petroll” SHPK, si person juridik, Njësia në fshatin Vragoli – Komuna e Fushë Kosovës, me Drejtor - Hasime Kryeziu, me NRB 81032162, e ka shpallur përgjegjëse:

– Sepse me datën 15.03.2022, rreth orës 11:50, gjatë inspektimit nga Inspektorët Eljesa Beqiri dhe Fixhrie Salihu - Inspektore të Tregut në MTI-së, si dhe në bashkëpunim me Inspektorët e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), në bazë Procesverbalit me Nr.19/00437, të datës 15.04.2022, të përpiluar në ora 11:50, është konstatuar se te Subjekti Ekonomik “AL Petroll” Sh.p.k me numër NRB: 81032162, me seli në fshatin Vragoli - Komuna e Fushë Kosovës, i cili merret me veprimtarin e shitjes me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës, lidhur me verifikimin e marzhës tregtare të derivateve të përcaktuar me Vendim Nr. 02/66 të datës 01.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e bazuar në Procesverbalin me Nr.19/00437 të datës 15.03.2022, dhe Raportit të Inspektorëve të Administratës Tatimore (ATK) të datës 15.03.2022, Subjekti Ekonomik “AL Petroll” Sh.p.k, **e ka tejkaluar marzhën tregtare të përcaktuar me Vendim Nr.02/06 të datës 01.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës,-**

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 15 par. 3 sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.3 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme lidhur me nenin 9 par. 2 pika 1.2 lidhur me nenin 26 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-121 për Mbrojtën e Konsumatorit, (sipas Aktvendimit për Korrigjim të datës 27.11.2023), andaj me aplikim të nenit 35 par. 1, të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, i ka shqiptuar dënim me gjobë **në shumën prej 4000(katërmijë)€, është obliguar e pandehura që gjobën e shqiptuar të paguan në afat prej 15 ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në xhirollogari të Këshillit Gjyqësor No.1000 4300 7000 0518, po ashtu i pandehuri obligohet që në afat të lartcekur të paguaj **10 (dhjetë) €**, në emër të paushallit gjyqësor, nëse i pandehuri nuk e bënë pagesën e gjobës në afatin e parapara me ligj, ekzekutimi do të bëhet sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e pandehura “Al Petroll” SHPK, përmes Përfaqësuesit të autorizuar Elmaze Jashari, për shkak të shkeljes së dispozitave të LPK-së, neni 42 par.1, neni 89 par.1 pika 1.3, par. 2 pika 4.3 neni 138 par.1.1, 1.2 1.3 dhe 1.4 , neni 139 par. 1 pika 1.9 dhe par. 2 , neni 140 par. 1 pika 1.3 dhe 1.5 , neni 141 par. 1 dhe par. 2 të LK-së. Konsideron se në rastin konkret ka arritur parashkrimi relativ, sepse kundërvajtja sipas Procesverbalit mbi Inspektimin të ATK-së, Nr. 19/00437 i datës 15.03.2022, konsiderohet se është kryer më datë 15.03.2022, ndërsa fillimi i procedurës kundërvajtëse sipas ftesës së parë të gjykatës është bërë 21.11.2023, pra nga data 15.03.2022 deri 21.11 2023, nuk është ndërmarr asnjë veprim procedural nga gjykata e ka kaluar më tepër se 1 vit pra 1 vit e 8 muaj, që do të thotë se parashkrimi relativ ka arritur më datë 16.03.2023, e sipas nenit 42 par. 1 të LK-së, “Procedura nuk mund të ndermirret nëse kanë kaluar më shumë se 1 vit, nga dita e kryerjes së kundërvajtjes”. Po ashtu arsytimi i aktgjykimit nuk përmban fakte mbi faktet vendimtare të cilat i ka cekë përfaqësuesja në seancën gjyqësore. Po ashtu ekzistoj rrethana që e përjashtoj përgjegjësin kundërvajtëse pasi që në rastin konkret ka arritur parashkrimi relativ dhe se gjykata nuk është dashtë të cakton fare shqyrtim gjyqësor por ta nxjerr aktvendimin për parashkrim relativ.

I propozon Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, që ankesa të aprovohet, si e bazuar aktgjykimi i ankimuar të Ndryshohet dhe e pandehura të lirohet nga përgjegjësia për shkak të arritjes së parashkrimit relativ ose të Anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar MINT- së, si ushtruese e kërkesës e cila ka propozuar që ankesa e të pandehurës të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji i kësaj gjykate, duke i vlerësuar thëniet në ankesë, aktgjykimin e goditur si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur nga e pandehura përmes Përfaqësuesit të autorizuar është e pabazuar dhe refuzohet, ndërsa aktgjykimi i goditur vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji konstatoj se gjykata e shkallës së parë, me rastin e zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, kundër të pandehurës në bazë të deklaratës së Përfaqësueses me autorizim Elmaze Jashari, të dhënë në Procesverbalin e seancës së datës 21.11.2023, e cila ka deklaruar se konsideron se në rastin konkret ka arritur parashkrimi relativ, sepse kundërvajtja sipas Procesverbalit mbi Inspektimin të ATK-së, Nr. 19/00437 i datës 15.03.2022, konsiderohet se është kryer më datë 15.03.2022, ndërsa fillimi i procedurës kundërvajtëse sipas ftesës së parë të gjykatës është bërë 21.11.2023, pra nga data 15.03.2022 deri 21.11.2023, nuk është ndërmarr asnjë veprim procedural nga gjykata e ka kaluar më tepër se 1 vit, pra 1 vit e 8 muaj, që do të thotë se parashkrimi relativ ka arritur më datë 16.03.2023, e sipas nenit 42 par. 1 të LK-së, “Procedura nuk mund të ndermirret nëse kanë kaluar më shumë se 1 vit, nga dita e kryerjes së kundërvajtjes”, në bazë të deklaratës së ushtrueses së Kërkesës – Inspektore Eljesa Beqiri, e cila u dëgjua në cilësi të dëshmitares, e cila ka mbet në tersi pranë kërkesë së ushtruar duke kërkuar që lënda të kryhet në bazë të ligjeve në fuqi, në bazë të Procesverbalit të inspektimit Nr. 19/00437, të datës 15.03.2022, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës, padyshim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se e pandehura ka kryer vepër kundërvajtëse, nga neni 15 par. 3 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregti me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme lidhur me nenin 9 par. 4 të Ligjit Nr.04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit sanksionuar me nenin 19 par. 13, nën par. 13.1 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, andaj në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për ndryshimin ose anulimin e aktgjykimit të goditur, siç pretendon përfaqësuesja me autorizim e të pandehurës në ankesë.

Kolegji të njëjtën aktgjykim e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe në këtë aspekt gjeti se nuk përmban shkelje nga neni 139 të LK-së, e të cilat detyrimisht do ta kishim kushtëzuar prishjen e aktgjykimit.

Kolegji, konstatoi se aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë, konkret, përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje kundërvajtëse dhe në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar e ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar si dhe ka dhënë arsyet e qarta për vërtetimin e tillë të fakteve.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore i përfaqësueses se në rastin konkret ka arit parashkrimi relativ nuk qëndron sepse:

Neni 42 par. 1 i LK-së, decidivisht thotë citim: “ Procedura e kundërvajtjes nuk mund të ndërmerret nëse kalon 1 vit, nga data kur është kryer kundërvajtja, në paragrafin 3 të njëjtit nenë thuhet citim: “ Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të organit kompetent që ndërmerret për ndjekjen e kryesit të kundërvajtje”, në rastin konkret organi kompetent Ministria e Industrisë, Nërmarrësisë dhe Tregtisë - Inspektorati i Tregut, me Kërkesë për fillimin e Procedurës kundërvajtëse me Nr. Ref 19/1680-19, të datës 21.03.2022, ka ngarkuar Subjektin Ekonomik “Al Petroll” SHPK, si person juridik, Njësia në fshatin Vragoli – Komuna e Fushë Kosovës, tani me Drejtor - Halim Kryeziu, me NRB 81032162, se kundërvajtjen e ka kryer me

datë 15.03.2022, Kërkesa në gjykatë ka arritur me datë 21.03.2022, dhe gjyqtari ka marr – nxjerr **AKTVENDIM** të posaçëm për fillimin e procedurës kundërvajtëse, më datë 10.03.2023 i cili gjendet në shkresa të lëndës konform nenit 88 të LK-së, që dmth se ka ndërmarr veprim para se të kalon 1 vit, nga veprimi i fundit data 21.03.2022 (kur ka arit kërkesa në gjykatë) dhe se me aktvendim është ndërpre parashkrimi relativ.

Kolegji ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer dhe shkallën e përgjegjësisë si dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i pandehuri nga kryerja e veprave në të ardhmen si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave të tilla kundërvajtëse.

Kolegji i kësaj gjykate i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore, mirëpo të njëjtat i vlerësoi se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme si dhe pa ndikim sepse në shkresa të lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plot dhe të drejtë.

Kolegji konstaton se, Gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procedurës nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kurse gjoba e shqiptuar ndaj të pandehurës, konform nenit 35 të LK-së, në shumë prej 4.000€, konsiderohet se është përcaktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, peshës së veprës së kryer, si rrethanave në të cilat është kryer vepra kundërvajtëse, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për ndryshimin e aktgjykimit të goditur.

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 2 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ka. nr. 449/2023, me datë 09.01.2023,



KRYETARJA E KOLEGJIT,
Azra Cakolli